



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
MINISTRI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" nr.1 Tiranë

URDHËR

Nr. 187 Datë 09 10.2014

PËR

MIRATIMIN E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË
MARRËVESHJES PËR KRYERJEN E Oponencës Teknike Për
PROJEKTET E VEPRAVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 18.7.2002 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, si dhe pikës 2, 4 të vendimit nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit",

URDHËROJ:

1. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, të kryhet nga Instituti i Ndërtimit për të gjitha objektet publike, që pajisen me leje zhvillimore ndërtimi, infrastrukture dhe komplekse, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
2. Oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, për objekte që nuk janë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri, të kryhet nga Instituti i Ndërtimit ose Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.
3. Subjektet, që do të kryejnë opionecën teknike për projektet e veprave të ndërtimit, para kryerjes së opionencës lidhin një marrëveshje me porositësin, sipas marrëveshjes tip bashkëlidhur këtij urdhëri.
4. Pagesa për opionecën teknike të projekteve të bëhet sipas pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e opionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit".

Nr. 4545 Prot

5.Urdhëri nr.7, datë 20.01.2014, i Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” , i ndryshuar me urdhërin nr.98.datë 08.05.2014, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
EGLANTINA GJERMENI

